



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Štrpce



Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 30/07/2021 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca te jashtezakonshme e kuvendit e mbajtur me 06.07.2021

1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.
2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit


Predrag Grbic





Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Štrpce



PROCESVERBAL

Nga seanca jashtëzakonshme e KK-ës të mbajtur më 06.07.2021, me fillim në ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Draft programi tre-vjeçar të banimit për 2021-2024

Predrag Grbiq: Mirëdita dhe mirësë keni ardhur në seancën e parë të jashtëzakonshme në këtë vit. Kur bëhet fjalë për seanca të jashtëzakonshme, ato caktohen me vetëm një pikë në rendin e ditës pa mundësinë e plotësimit. Janë 14 këshilltarë të pranishëm. Plani ishte që drejtori i urbanizmit të na e paraqiste këtë draft sepse ai ka qenë gjithashtu kryetar i komisionit, por ai mungonte me arsye, kështu që drejtori i administratës do të na tregojë se çfarë është e rëndësishme për këtë dokument.

Havzi Ahmeti: Ky draft tashmë është miratuar nga Kuvendi një herë, sepse ai miratohet çdo tre vit me ligj dhe ai nuk është më i validë, kështu që ne jemi të detyruar ta miratojmë përsëri. Duke marrë parasysh faktin se kemi hasur në probleme me qytetarët kur bëhet fjalë për çështjet e banimit, siç e dini, kemi pasur një investim nga organizatat ndërkombëtare në Brezovic. Ne kemi marrë atë program të vjetër dhe kemi ndryshuar disa pika dhe kemi dorëzuar juve të njëjtin lidhur me banimin në komunën tonë, dhe gjithçka është bërë në bazë të ligjit dhe rregullores së Ministrisë së Mjedisit. Na si komunë, pas miratimit të këtij programi, jemi të obliguar që të zbatojmë disa akte dhe disa programe për banimin të veçantë që janë të validë në Kosovë. Pas miratimit, hapen rrugët për hapjen e masave të reja, donatori i cili ka investuar në Brezovic ka thënë që ne i kemi përmbushur ato pak pika të cilat ai ka përmendur se ku është bërë zhvendosja e personave që kanë jetuar në ato qendra kolektive. Ka banesat të zbrazëta dhe duhet të fillohet procedura në mënyrë që njerëzit e tjerë të vendosen atje, por kjo nuk është e mundur nëse nuk e miratojmë këtë program.

Radojka Repinoviq: Zgjidhja e çështjes së strehimit është çështja më e prioritetit dhe çdo vetëqeverisje lokale, gjithashtu duke përfshirë edhe komunën e Shtërpçës. Duke formuar një komision për hartimin e draftit, ne kemi një pasqyrë reale të situatës aktuale në komunë. Ai përmban të dhëna dhe fakte të detajuara në lidhje me angazhimin e deritanishëm të komunës për

këtë çështje, si dhe plane dhe shpjegime të mëtejshme për pjesëmarrje më aktive të të gjitha institucioneve, të cilat gjithashtu janë të obliguar të tregojnë angazhim konkret në zgjidhjen e programit të banimit. Bazuar në gjithçka të propozuar në draft, unë propozoj miratimin e tij.
PredragGrbiq :Askush nuk po lajmërohet më për fjalë. Qes në votim këtë pikë. Kush është për?
Konstatoj që më një zër kemi aprovuar këtë draft

Falënderoj në pjesëmarrje seanca e sotme ka mbaruar.

Procesmbajtësi
StajaMarkoviq



Kryesuesi i Kuvendit
PredragGrbiq
